



Në bazë të nenit 10 të Ligjit Nr.03/L-139,për Shpronësimin e pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205,dhe Nenit 97 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën administrative,të Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit, komentimit dhe intervistimit të palëve, brenda afatit ligjor, Kryetari i Komunës së Gjakovës, Z.Ardian Gjini, mori këtë:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

- 1. APROVOHET** kërkesa e subjektit kërkuar, Komunës së Gjakovës, për shpronësim për interesin publik të pronareve të pronave të paluajtshme dhe zotëruesve të interesit, të cilat ndodhen në zonën kadastrale të Komunës së Gjakovës, Z.K.Gjakovë-j.qytet, e qëllimi për të cilin shpronësohen ka të bëjë me ndërtimin e segmentit të rrugës tek “Banesat Sociale” në Gjakovë, për parcelat me nr.5077-7, 5077-11, 5077-10 dhe 5771-0, me kompensimin e pronave të shpronësuara të pronarëve dhe i dëmeve, për ngastrat kadastrale, sipas tabelave të bashkangjitura këtij Vendimi.
- 2.** Pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar brenda 5 (pesë) ditëve të punës, njoftohen pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen që brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit i njëjti do të shpallet në gazetën zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.
- 3.**Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda (30) tridhjetë ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, subjekti kërkuar dhe cili do person i cili është pronarë ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
- 4.**Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Gjakovës.
- 5.**Vendimi hyn në fuqi me datën e shpalljes së tij në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

Kryetari i Komunës së Gjakovës

Ardian Gjini



Vendimi iu dërgohet:

- Kabinetit të Kryetarit;
- Shërbimi profesional të Kuvendit të Komunës;
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Drejtorisë për Shërbime Publike;
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër e Pronë;
- Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO						
KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË						
SKUPSTINA OPSTINE DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA						
Rruga për tek Banesa Sociale						
Nr.Rend or	Nr. i Parcelës	Pronari	Sipërfaqja totale[m ²]	Sipërfaqja për shpronësim [m ²]	Sipërfaqja e mbetur [m ²]	Zona Kadastrale
1	5077-7	1/1 Teuta Kusuari	1076	190	886	Gjakove - J. Qytet
2	5077-11	91/100 Lulzim Morina 9/100 Naim Morina	859	36	823	Gjakove - J. Qytet
3	5077-10	1/1 Gazmend Canhasi	750	272	478	Gjakove - J. Qytet
4	5771-0	1/1 Ismet Doli	15448	2790	12658	Gjakove - J. Qytet
			Sip. totale për shpronësim	3288	m ²	

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Drejtori:

IDE, Afërdita LAMA